



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 27.05.2015

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT TË VIJËS LUMORE DHE ISHULLIT TË OSUMIT NË QYTETIN E BERATIT, SIPAS PROJEKTIT FITUES TË KONKURSIONIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të neneve 7, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të vijës lumore dhe ishullit të Osunit në Qytetin e Beratit, sipas projektit fitues të Konkursit Ndërkombëtar, përzgjedhur nga juria e tij më datë 27.05.2015.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është planimetria e projektit fitues të propozuar nga skuadra fituese – UNLab, Openfabric, CoRDA, Kreshnik Merxhani, Arjan van Timmeren.
3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Berat të ndjekin procedurat për realizimin e projektit fitues, në bashkëpunim me skuadrën fituese UNLab, Openfabric, CoRDA, Kreshnik Merxhani, Arjan van Timmeren.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA





ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT